



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 11713 (31015-00912-86-2016) Rregj.Them.

Nr. 640 (86-2016-181) Vendimi

Data Regjistrimi 29.02.2016

Datë 24.03.2016

V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA

GJYQTAR - Altina NASUFI

GJYQTAR - Rilinda SELIMI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore [REDACTED] në Tiranë, sot me datë 24.03.2016, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë :

**PADITËSE:** [REDACTED] e bija e [REDACTED] dhe [REDACTED] e datëlindjes [REDACTED] lindur në [REDACTED] dhe banuese në lagjen [REDACTED]

**I PADITUR:** Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me seli në adresën: Rruga "Sami Frashëri", nr. 10, kati i II-të, Tiranë.

**OBJEKTI:** Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendim nr. 110, datë 03.07.2015 të Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi.

**BAZA LIGJORE:** Neni 32/a, 154 i K. Pr. Civile, nenet 14, 15,16,17, të ligjit nr. 49/2012, ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", K. Pr. Administrative.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të çështjes me vendimin nr. 6089 (80-2015-4378), datë 01.12.2015 ka vendosur:

1. "Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj e në prova.
2. Shpenzimet procedurale gjyqësore i ngarkohen palës paditëse".

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka paraqitur ankim pala paditëse, duke parashtruar se:

1. Neni 33/10 i ligjit nr. 10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" përcakton se: "Komisioneri shprehet me vendim, i cili iu njoftohet palëve brenda 90 ditëve nga dita e

marrjes së ankesës ose nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore publike, brenda 90 ditëve nga dita e seancës. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre". Nga data 23.02.2015 e zhvillimit të seancës dëgjimore deri në datën 03.07.2015 të marrjes së vendimit nr. 110 të po kësaj date kanë kaluar 131 ditë. Ky vendim është marrë me 41 ditë vonesë referuar afatit 90 ditor. Pala e paditur nuk ka respektuar afatin prekluziv 90 ditor të parashikuar në ligj për marrjen e vendimit, nga momenti i zhvillimit të seancës dëgjimore publike.

2. Konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se, tejkalimi i afatit ligjor është një "parregullsi", por kjo nuk e bën aktin apriori absolutisht të pavlefshëm nuk qëndron. Një vendim i tillë tej afatit 90 ditor është absolutisht i pavlefshëm për shkak të inkompetencës së palës së paditur për ta marrë atë.
3. Mosrespektimi i afatit ligjor e bën palën e paditur të humbasë fuqinë juridike për të vepruar, inkompetente për të marrë vendim dhe rrjedhimisht e bën vendimin e palës së paditur absolutisht të pavlefshëm. Me kalimin e afatit ligjor organi i administratës nuk ka më pushtet të vendosë për atë çështje, pasi kjo fuqi ka humbur me kalimin e afatit të përcaktuar në ligj. Mos nxjerrja në kohë e vendimit me dashje apo nga pakujdesia, ndaj një kërkesë që detyron organin për të proceduar, përbën shkelje.
4. Kompetenca kështu përbën kushtin themelor të vlefshmërisë së një akti administrativ, mungesa apo tejkalimi i së cilës sjell pasjell pavlefshmërinë absolute të tij siç parashikohet në nenin 116/b të K. Pr. Administrative.
5. Në rastin konkret, ligji ndonëse i ka njohur të drejtën e nxjerrjes të akteve, palës së paditur, kjo e drejtë është në kohë e për rrjedhim ajo duhet të ushtrohet brenda afatit të përcaktuar. Veprimi i palës së paditur në nxjerrjen e aktit administrativ në një moment kur ligji nuk ia njihet më këtë të drejtë, e cilëson si absolutisht të pavlefshëm këtë akt, si i nxjerrë në tejkalim të kompetencave.
6. Një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk prodhon asnjë pasojë juridike referuar nenit 117 të K. Pr. Administrative e për këtë shkak me të drejtë kërkoj konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendimin nr. 110, datë 03.07.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa sipër, pala paditëse kërkon ndryshimin e vendimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesë padisë sipas objektit si të bazuar në ligj e në prova.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

#### VËREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë në datën 29.07.2015 me kërkesë padi duke kërkuar:

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendim nr. 110, datë 03.07.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ vendim nr. 110, datë 03.07.2015 Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pala paditëse në lidhje me këto kërtime i ka referuar si bazë ligjore në nenet 32/a, 154 i K. Pr. Civile, nenet 14, 15,16,17, të ligjit nr. 49/2012, ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", K. Pr. Administrative.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 1199, datë 17.09.2015 ka vendosur: Moskompetencën tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe dërgimin e çështjes për kompetencë gjykimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të çështjes me vendimin nr. 6089 (80-2015-4378), datë 01.12.2015 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë padisë.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur ankim në datën 15.12.2015 pala paditëse.

Konstatohet se ankimi i paraqitur nga pala e paditur është përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, duke u verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tij, e për rrjedhojë, është shoqëruar me vendimin e gjyqtarit që ka pranuar ankimin.

Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

#### *Rrethanat e çështjes*

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 6089 (80-2015-4378), datë 01.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezulton se:

Paditësja [REDAKTUAR] është përgjegjëse e departamentit të ekonomisë pranë Fakultetit të Ekonomisë së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Pala e paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në datën 21.11.2014 ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetases [REDAKTUAR] (me pozicion pune pedagoge pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë) kundër Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", dekanit të Fakultetit Ekonomik dhe palës paditëse në cilësinë e përgjegjëses së departamentit të ekonomisë.

Shtetësja [REDAKTUAR] në ankesën e saj ka pretenduar se është diskriminuar për shkak të qëndrimeve të saj denoncuese ndaj shkeljeve të ligjit dhe rregullores së Unversitetit "Ismail Qemali", nga këto autoritete.

Paditësja pretendon në ankimin e saj se është trajtuar nga organet Unversitetit "Ismail Qemali" Vlorë në mënyrë të pabarabartë nga kolegët e tjerë pedagogë të këtij universiteti, konkretisht:

1. Gjatë vitit 2013-2014 i është mohuar pagesa e mbingarkesës mësimore në kundërshtim me ligjin "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe me rregulloren e universitetit.
2. I janë hequr lëndë nga ngarkesa e zakonshme mësimore në sezonin verë-vjeshtë 2014.
3. Në diferencë nga kolegët e tjerë, nuk i është miratuar leje për qëllim të hulumtimit shkencor.
4. Kërkuesja ka kërkuar nga Komisioneri ndalimin e diskriminimit në vendin e punës dhe respektimin e të drejtave të saj.

Pala e paditur në zbatim të neneve 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 ka iniciuar procedimin administrativ për shqyrtimin e ankesës së shtetases [REDAKTUAR]

Komisioneri me shkresën e tij nr. 1002/1 Prot. Datë 09.12.2014 ka njoftuar Rektorin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për fillimin e procedurës administrative, si dhe i ka kërkuar informacion për pretendimet e ngritura në ankimin e shtetases [REDACTED]. Komisioneri në datën 11.02.2015 ka kryer një inspektim pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Në këtë inspektim është kryer takim ndërmjet inspektorëve të palës së paditur dhe Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Dekanit të Fakultetit Ekonomik dhe palës paditëse. Ky takim është dokumentuar nga inspektorët në procesverbalin e përpiluar për këtë qëllim.

Komisioneri me shkresën nr. 160/3 Prot. Datë 13.02.2015 ka njoftuar Rektorin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Dekanin e Fakultetit Ekonomik, palën paditëse dhe shtetasen [REDACTED] [REDACTED] ankuese se seanca dëgjimore për çështjen e kësaj të fundit do të zhvillohet në datën 23.02.2015 në mjediset e Zyrës së Komisionerit.

Në datën 23.02.2015 është zhvilluar ky takim në të cilin është paraqitur vetëm ankuesja, që është dokumentuar në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim (fq. 22 e fashikullit).

Pala e paditur në vijim me shkresën nr. 189/2 Prot. Datë 23.02.2015 i ka kërkuar informacion shtesë palës së paditur në lidhje me ankesat që ankuesja [REDACTED] ka parashtruar në seancën dëgjimore të mbajtur në mjediset e zyrës së Komisionerit.

Pala paditëse në cilësinë e përgjegjëses së departamentit të ekonomiksit pranë Fakultetit të Ekonomisë me shkresën nr. 210 Prot. Datë 03.03.2015 "Kthim përgjigje dhe parashtrim i kundër-argumentave në lidhje me ankesën e znj. [REDACTED] (fq. 75 e fashikullit nr. 1) i ka kthyer përgjigje palës së paditur. Në këtë shkresë pala paditëse ka bërë një parashtrim të zgjeruar të argumentave të saj ndaj pretendimeve për diskriminim të ankueses [REDACTED] duke iu referuar të gjithë praktikës administrative të ndjekur deri në këtë moment nga pala e paditur.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së ankueses [REDACTED] Komisioneri me vendimin nr. 110, datë 03.07.2015 (fq. 37 e fashikullit) ka vendosur:

1. "Konstatimin e drejtëpërdrejtë të znj. [REDACTED] për shkak të qëndrimeve të saj kritike dhe denoncimeve të bëra kundër strukturave drejtuese të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, nga ana e përgjegjëses së Departamentit të Ekonomiksit, përmes mospagesës së mbingarkesës së orëve mësimore për vitet 2013-2014.
2. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi i rekomandohet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë të marrë masa për hartimin e një udhëzimi për procedurën që duhet ndjekur për mënyrën e pagesës së mbingarkesës së orëve mësimore.
3. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. [REDACTED] nga ana e përgjegjëses së Departamentit të Ekonomiksit përmes heqjes së lëndëve mësimore.
4. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. [REDACTED] nga ana e Dekanes së Fakultetit Ekonomik përmes mosmiratimit të lejes për hulumtim shkencor...".

Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë padi me objekt:

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendim nr. 110, datë 0.07.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ vendim nr. 110, datë 0.07.2015 Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 1199, datë 17.09.2015 ka vendosur:

Moskompetencën tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe dërgimin e çështjes për kompetencë gjykimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në vijim, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për ndryshimin e objektit të padisë duke e pakësuar atë në:

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendim nr. 110, datë 0.07.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të çështjes me vendimin nr. 6089 (80-2015-4378), datë 01.12.2015 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë padisë.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 6089 (80-2015-4378), datë 01.12.2015 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë rezulton se gjykata e shkallës së parë ka arritur në këtë zgjidhje me arsyetimin e mëposhtëm:

1. Lidhur me paligjshmërinë e aktit administrativ të kundërshtuar gjyqësisht paditësja i referohet nenit 116 të K. Pr. Administrative. Nëpërmjet kësaj dispozite ligjore që përbën dhe bazën juridike të kërkesë padisë, paditësja e ka orientuar shqyrtimin gjyqësor në analizën e ekzistencës ose jo të shkaqeve të pavlefshmërisë absolute të aktit. Gjatë analizimit të fakteve të çështjes i referohet dhe nenit 33/10 të ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
2. Rezulton e provuar se nga data 23.02.2015 e seancës dëgjimore publike të zhvilluar në datën 03.07.2015 të daljes së vendimit objekt gjykimi kanë kaluar 131 ditë, pra më shumë se 90 ditë. Pala e paditur nuk ka respektuar afatin 90 ditor të parashikuar në ligj për marrjen e vendimit nga momenti i zhvillimit të seancës dëgjimore publike.
3. Shkelja e formës dhe e procedurës mund të paraqitet në forma të ndryshme, por jo të gjitha shkeljet që lidhen me formën dhe procedurën mund të shpien detyrimisht në pavlefshmërinë e aktit. Një shkelje e parëndësishme e procedurës apo formës së aktit nuk mund të shkaktojë pavlefshmëri absolute të aktit.
4. Në rastin konkret gjykata konstaton se tejkalimi i afatit ligjor të vendimmarrjes mund të konsiderohet një parregullsi apo mosrespektim i një kërkesë formale/procedurale të parashikuar në ligj, por kjo nuk e bën aktin apriori absolutisht të pavlefshëm.
5. Duke marrë në konsideratë parregullsitë procedurale në veprimtarinë e Komisionerit të pretenduara nga pala paditëse Gjykata arsyeton se jemi në kushtet e nenit 40/4 të ligjit nr. 49/2012.

Gjykata Administrative e Apelit e shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

#### Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të vendimit objekt ankimi, të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit të posaçëm dhe atij procedural që gjejnë zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Vendimi nr. 6089 (80-2015-4378), datë 01.12.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është

marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material që gjen zbatim në rastin konkret dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Së pari: Pala paditëse në ankimin e saj ka parashtruar se pala e paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e ka marrë vendimin objekt i këtij shqyrtimi gjyësor jashtë afatit 90 ditor të përcaktuar nga neni 33/10 i ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Marrja e këtij vendimi jashtë afatit 90 ditor sjell moskompetencën e palës së paditur për të marrë këtë vendim.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ky pretendim i palës paditëse është i pabazuar në ligj e në prova dhe si i tillë është i papranueshëm.

Në rastin objekt gjykimi konstatohet se vendimi është marrë jashtë afatit 90 ditor të përcaktuar nga ligji nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", por nga ana tjetër ky ligj nuk parashikon se marrja e vendimit jashtë këtij afati sjell moskompetencën për të marrë vendim nga ky organ administrativ.

Konkretisht neni 33 pika 10 i ligjit nr. 10221/2010 përcakton se:

*"Komisioneri shprehet me vendim, i cili iu njoftohet palëve brenda 90 ditëve nga dita e marrjes së ankesës, ose nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore publike, brenda 90 ditëve nga dita e seancës. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre".*

Kjo Gjykatë çmon se, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se shkelja e këtij afati nga pala e paditur-organ publik nuk sjell pavlefshmëri të aktit administrativ të nxjerrë prej saj. Pamvarësisht se pala e paditur nuk ka respektuar afatin për njoftimin e vendimit të saj palëve pjesëmarrëse në procedimin administrativ, ajo ka respektuar procedurën ligjore për marrjen e këtij vendimi, duke zhvilluar një hetim administrativ në përputhje me K. Pr. Administrative, si dhe me ligjin nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Ligji në rastin konkret ka përcaktuar detyrimin e Komisionerit që të bëjë njoftimin e vendimit palëve pjesëmarrëse në procedimin administrativ brenda 90 ditëve, por afatet e zhvillimit të procedimit administrativ janë të përcaktuara në K. Pr. Administrative. Kompetenca në marrjen e vendimit nuk ka të bëjë me afatet e bërjes së njoftimeve, por ka të bëjë me afatet që K. Pr. Administrative, apo ligji i posaçëm përcaktojnë për zhvillimin e hetimit administrativ, paraqitjen e ankimeve, etj.

Së dyti: Pala e paditur në ankimin e saj ka parashtruar se vendimi nr.110, datë 03.07.2015 është një akt absolutisht i pavlefshëm referuar nenit 116/c të K. Pr. Administrative, pasi veprimi i palës së paditur në nxjerrjen e aktit administrativ në një moment kur ligji nuk ia njihnte më këtë të drejtë, e cilëson si absolutisht të pavlefshëm këtë akt.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ky pretendim i palës paditëse është i pabazuar në ligj e në prova dhe si i tillë është i papranueshëm.

Kjo Gjykatë, vlerëson se akti administrativ i kundërshtuar nga pala paditëse nuk përmban elementë të pavlefshmërisë së formës dhe të procedurës, të cilat sjellin si pasojë pavlefshmërinë absolute të tij.

Përsa i përket formës, Gjykata vlerëson se akti përmban të gjitha elementët e formës së përcaktuar në nenin 99 të K. Pr. Administrative. Konkretisht, akti përmban organin që e ka nxjerrë, datën e miratimit, palët të cilave u drejtohet, bazën ligjore, pjesën arsyetuese, pjesën rekomanduese, si dhe të drejtën e ankimit ndaj tij.

Në lidhje me procedurën e ndjekur nga pala e paditur, Gjykata çmon se, me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se pala e paditur ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë e në përputhje me ligjin nr. 10221/2010.

Pamvarësisht se pala e paditur nuk i ka njoftuar palët pjesëmarrëse në procedim për vendimin e saj brenda afatit 90 ditor, vendimi i saj nuk do të ndryshonte dhe po ti ishte njoftuar palëve brenda këtij afati, pasi të gjitha veprimet proceduriale janë kryer në përputhje me ligjin nr. 10221/2010, siç janë përshkruar nga Kjo Gjykatë dhe në rrethanat e çështjes sa më sipër.

Për pasojë, Kjo Gjykatë çmon se ndodhemi në kushtet e nenit 40 pika 4 të ligjit nr. 49/2012, siç ka vlerësuar me të drejtë dhe Gjykata e Shkallës së Parë.

Sa më sipër, pretendimet e parashtruara nga pala paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit për kundërshtimin e vendimit nr. 6089 (80-2015-4378), datë 01.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe si të tilla të papranueshme.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", vlerëson se vendimi nr. 6089 (80-2015-4378), datë 01.12.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të lihet në fuqi.

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 50 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012

*"Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",*

#### VENDOSI

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 6089 (80-2015-4378), datë 01.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 nga njoftimi i këtij vendimi.

*U shpall në Tiranë sot më datë 24.03.2016.*

GJYQTAR  
Rilinda SELIMI  
d.v

GJYQTAR  
Altina NASUFI  
d.v

GJYQTAR  
Kastriot SELITA  
d.v

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelari  
Leonard Steatij  
Becaj

